

Deklarimi i privatësisë

Vlerësimi i Talking Time (Koha e të folurit / Koha e bisedës)

Hyrje

Vitet e vegjëlisë së fëmijës suaj po marrin pjesë në një projekt kërkimor që teston ndikimin e një programi të quajtur 'Talking Time' (I cili në shqip përkthehet si Koha e të folurit apo edhe koha e bisedës. Megjithatë në vazhdim ne do ti referohemi si Talking Time). Talking Time përfshin aktivitete dhe lojëra të cilat janë krijuar për të zhvilluar aftësitë e të folurit dhe të dëgjuarit të fëmijëve.

Projekti Talking Time është një bashkëpunim midis Education Endowment Foundation (EEF) (Shqip: Fondacioni i Dhurimit të Arsimit), Thrive Together Early Early Stronger Practice Hub (SPH) (Shqip: Qendra e praktikës “Lulëzoni së bashku vitet e vegjëlisë”), Rajoni i qytetit të Liverpulit dhe Beyond Early Years SPH (Shqip: Përtej viteve të vegjëlisë), REACHout Early Years SPH, / A Brighter Start Early Years SPH (Shqip: Një fillim më i ndritshëm i vegjëlisë), Universiteti i Oksfordit, Kolegji Universitar i Londrës (UCL), Instituti i Arsimit, Instituti Kombëtar i Kërkimeve Ekonomike dhe Sociale (NIESR) dhe Fondacioni Nuffield. Rolet e secilës prej këtyre organizatave janë:

- EEF dhe Stronger Practice Hubs apo shkurt SPH-të (SPH-të janë qendra praktike të hapura nga qeveria që mundësojnë këshilla dhe praktikë për profesionistët që punojnë me fëmijët e moshave të vogla) e përmendura më sipër janë financuesit e projektit. Fondacioni Nuffield është duke bashkëfinancuar aspekte të veçanta të projektit (incizimet audio të praktikës dhe analizat përkatëse).
- Si pjesë e [të Rimëkëmbjes në Vitet e Hershme të Departamentit të Arsimit](#) Stronger Practice Hubs dhe EEF po punojnë në Programin e Departamentit për Rimëkëmbjen e Arsimit pas pandemisë Covid-19. Ata po përpiqen të mbledhin prova rreth ndikimit të programeve të ndryshme në zhvillimin e fëmijëve dhe të përmirësojnë trajnime efektive për praktikantët.. Kjo nismë synon të mbështesë rimëkëmbjen e arsimit pas pandemisë, ndërkohë që na ndihmon neve të kuptojmë zhvillimin efektiv profesional në vitet e para të fëmijërisë. SPH-të që marrin pjesë në Talking Time janë përmendur më lart .
- Universiteti i Oksfordit dhe Instituti i Arsimit UCL do të jenë përgjegjës për hartimin dhe ofrimin e programit; për mbledhjen e regjistrimeve audio të praktikës; dhe për mbledhjen e informacionit se si stafi zbaton Talking Time (përfshirë videot e seancave). Ata do ta përdorin këtë informacion për të kuptuar se si stafi që punon me fëmijët e vegjël ndërvepron me fëmijët dhe se si i mbështetin ata gjuhën e fëmijëve, por po ashtu për të zbuluar se si e përdorin programin Talking Time dhe për të vlerësuar ndikimin e programit në praktikën e stafit.
- NIESR do të vlerësojë rezultatet e nxjerra nga ndikimi i programit tek fëmijët, i mbështetur nga një ekip nga një organizatë tjetër kërkimore, Qa Research. Ata

gjithashtu do të eksplorojnë përvojat e praktikuesve të programit dhe perceptimet e tyre për ndikimin e tij.

- 'Ekipi i Kërkimit' në këtë deklaratë privatësie i referohet UCL IOE, Universitetit të Oksfordit dhe NIESR.

Kjo punë është shqyrtuar dhe ka marrë miratimin nga komiteti i etikës në NIESR dhe gjithashtu një nënkomitet i Komitetit të Etikës së Kërkimit në Universitetin Qendror të Universitetit të Oksfordit. (Referenca e etikës në Universitetin e Oksfordit: EDUC_C1A_24_011_Amendment_01 ; kodi i projektit NIESR EP30).

Ky njoftim për privatësinë përcakton se si Ekipi Kërkimor do të mbledhë dhe përdorë të dhënat tuaja personale. Për të kryer rolet e tyre (të përcaktuara më lart), anëtarët e Ekipit Kërkimor do të bëhen kontrollues të të dhënave të grupeve të ndryshme të të dhënave të mbledhura. NIESR do të bëhet një kontrollues i pavarur i të dhënave të nxënësve, dhe të dhënat e vlerësimit të mbledhura për vlerësimin dhe së bashku me Universitetin e Oksfordit do të jetë kontrollues i deklaratave të miratimit për nxënësit. UCL dhe Oxford do të jenë kontrollues të përbashkët të të dhënave të regjistruara dhe video dhe audio-regjistrimet e praktikës të mbledhura gjatë këtij studimi.

Të dhënat e fëmijës suaj do të trajtohen me konfidencë strikte dhe do të përpunohen në përputhje me GDPR të Mbretërisë së Bashkuar dhe Aktin e Mbrojtjes së të Dhënave 2018. Ne nuk do të përdorim emrin e fëmijës tuaj në asnjë raport që del nga hulumtimi.

Ne premtojmë të respektojmë çdo të dhënë personale që është nën kontrollin tonë dhe t'i mbajmë të sigurt këto të dhëna. Ky njoftim/deklaratë privatësie përcakton se çfarë do të bëjmë me të dhënat tuaja dhe ne gjithashtu do t'ju njoftojmë për çdo ndryshim material në këtë njoftim.

Ekipi Kërkimor merret dhe ndan të dhënat tuaja personale sipas një marrëveshjeje për ndarjen e të dhënave të bërë midis anëtarëve të Ekipit Kërkimor. Marrëveshja përcakton qëllimet për të cilat ne mund të përpunojmë dhe ndajmë të dhënat tuaja personale dhe po ashtu përcakton marrëveshjen tonë për të bashkëpunuar, për të mbrojtur të dhënat tuaja personale dhe për t'u marrë me çdo kërkesë që mund të keni.

Çfarë lloj informacioni mbledhim?

Me pëlqimin tuaj të qartë, vendi arsimor i fëmijës suaj do të ndajë me NIESR informacionin e mëposhtme:

- Emri i fëmijës
- Emri i ambientit edukativ
- Data e lindjes
- Gjinia
- Mundësinë për të përfituar nga Early Years Pupil Premium (fondet që mund të merrni nga qeveria)

- Çdo nevojë shtesë, p.sh. nëse fëmijët tuaj kanë nevojë për ndonjë mbështetje shtesë me gjuhën e folur
- Pjesëmarrja javore
- Të dhënat e pjesëmarrjes në seancat e Talking Time
- Nëse fëmija juaj përdor anglishten si gjuhë dytësore
- UPN

Gjithashtu do t'ju kërkojmë t'i përgjigjeni një pyetjeje në lidhje me gjuhët që fliten në shtëpi. Formulari për të marrë miratimin tuaj për të marrë pjesë në studim do t'ju pyesë nëse ju dhe familja juaj flisni në shtëpi: kryesisht anglisht, një përzierje e anglishtes dhe gjuhëve të tjera, ose kryesisht gjuhë të tjera.

NIESR do të përputh dhe do të përpunoj informacionin e listuar më sipër me të dhënat nga vlerësimet e gjuhës së fëmijëve të kryera si pjesë e projektit. Këto janë vlerësime standarde të aftësive gjuhësore. Këto vlerësime do të administrohen nga një ekip nga Qa Research. Vlerësimet do të regjistrohen si audio për të vlerësuar sa më mirë dhe në mënyrë korrekte. Këto vlerësime do të përdoren vetëm për t'i mundësuar ekipit hulumtues të identifikojë nëse programi Talking Time ka një ndikim në aftësitë gjuhësore të fëmijëve të vegjël.

Si pjesë e projektit, por vetëm me pëlqimin tuaj, fëmija juaj mund të përfshihet në:

- Regjistrimet audio të dy seancave të shpërndarjes së librave (dy seanca afër fillimit dhe dy seanca afër fundit të projektit)
- Regjistrimet video të sesioneve të Talking Time si pjesë e mentorimit dhe reagimit për praktikuesit që janë pjesë e programit; dhe për të parë se si zbatohet programi.

Aty ku **prindërit kanë dhënë miratimin e tyre** për këto **regjistrime audio dhe video** të fëmijës së tyre, këto regjistrime do të krijohen dhe ndahen vetëm me ekipin e Universitetit të Oksfordit. Edhe pse fëmija juaj do të jetë i dukshëm dhe i dëgjueshëm në video, dhe anëtari i stafit mund të përdorë emrin e tij gjatë regjistrimit, kjo nuk do të publikohen kurrë.

Meqenëse UCL është një kontrollues i përbashkët i të dhënave me Universitetin e Oksfordit për regjistrimet video dhe audio dhe regjistrimet e pjesëmarrjes në sesionin e Talking time, ekipi i Oksfordit mund t'i ndajë këto të dhëna me ekipin në UCL për qëllime kërkimore. Oxford dhe UCL mund të përputh të dhënat nga këto audio regjistrime me informacionet e marra nga vlerësimet e gjuhës së fëmijëve.

Çfarë bëjmë ne me informacionin që mbledhim?

Çdo organizatë do të përdorë të dhënat për qëllime të ndryshme:

Universiteti i Oksfordit dhe Instituti i Edukimit UCL do të përdorin këto të dhëna si më poshtë:

- Për të ekzekutuar programin në ambjentet me fëmijë të vegjël dhe për të kuptuar se si zbatohet ky program
- Për të vepruar si pika kryesore e kontaktit për mjedset edukative

- Për të kuptuar se si stafi që punon me fëmijët në vitet e para të vegjëlisë ndërvepron me fëmijët dhe se si ky staf mbështet gjuhën e tyre,
- Për të vlerësuar ndikimin e programit kur praktikohet në mjedise ku ka fëmijë të vegjël, duke eksploruar nëse programi ka një ndikim në mënyrën në të cilën praktikuesit ndërveprojnë me fëmijët dhe rolin që luan ky program në mbështetjen e aftësive gjuhësore të fëmijëve.
- Për të kontaktuar ambjentet edukative kur publikohet raporti i vlerësimit
- Për të kontaktuar ambjentet edukative mbi përditësimet e programit dhe eventeve të ardhshme të Talking Time, nëse këto ambjente kanë treguar pëlqimin e tyre për t'u kontaktuar pas përfundimit të programit

NIESR

- Për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e Talking Time
- Për të zgjedhur në mënyrë të rastësishme ambjentet edukative që do të marrin apo nuk do të marrin pjesë në program
- Për të përputhur të dhënat e marra nga shkollat dhe cerdhet me të dhënat NPD dhe të dhënat e rezultateve të fëmijëve
- Për të kontaktuar disa vende që kërkojnë që stafi të marrë pjesë në intervista dhe/ose anketa në lidhje me përvojën e tyre gjatë ofrimit të Talking Time, apo pr t kryer intervista/anketime dhe për të analizuar këto të dhëna.
- Të udhëzojë dhe të ndërlihet me Qa , stafi i pavarur i të cilit është i trajnuar për të kryer testet dhe për të mbikëqyrur mbledhjen e të dhënave nga rezultatet e fëmijëve
- Të vlerësojë ndikimin dhe efektivitetin e programit dhe të përgatisë një raport rreth projektit

EEF

- Në fund të projektit, të dhënat e marra nga rezultatet e fëmijëve do të dorëzohen në arkivin e të dhënave të EEF, i cili menaxhohet nga Trusti i Familjes Fischer (FFT). Në këtë pikë, EEF do të bëhet një kontrollues i të dhënave dhe FFT do të jetë një përpunues i të dhënave

Ne do t'i përdorim të dhënat e fëmijës suaj vetëm për qëllimet për të cilat i kemi mbledhur, përveç rastit kur mendojmë në mënyrë të arsyeshme se duhet t'i përdorim për një arsye tjetër dhe nëse arsyeja është në përputhje me qëllimin fillestar. Nëse na duhet t'i përdorim të dhënat tuaja për një arsye që nuk lidhet me qëllimin fillestar, do të kërkojmë miratimin tuaj për t'i përdorur ato për qëllimin e ri. Të dhënat e fëmijës suaj do të trajtohen me konfidencën strikte dhe në përputhje me GDPR dhe Aktin e Mbrojtjes së të Dhënave 2018. Për qëllime kërkimi dhe arkivimi, të dhënat e ofruara nga ambjentet edukativ dhe të dhënat e vlerësimit/studimit do të ndahen me Universitetin e Oksfordit, Kolegjin Universitar të Londrës, Departamentin e Arsimit, EEF, menaxherin e arkivave të EEF dhe në një formë anonime me Zyrën për Statistikat Kombëtare dhe ekipe të tjera potenciale kërkimore. Përputhje e mëtejshme me NPD-në dhe të dhëna të tjera administrative mund të bëhet gjatë kërkimeve të mëvonshme.

Cila është baza ligjore për përpunimin e të dhënave tuaja personale?

Ne do t'i përdorim të dhënat tuaja personale vetëm kur kemi një bazë të ligjshme për ta bërë këtë.

- Baza ligjore e NIESR për përpunimin e të dhënave personale është ' interes legjitime' . Vlerësimi i Talking Time përmbush një nga qëllimet thelbësore të NIESR (ndërmarrja e aktiviteteve kërkimore, vlerësimi dhe informacioni) dhe për këtë arsye është në interesin tonë legjitim, që përpunimi i informacionit personal/të dhënave personale është i nevojshëm për kryerjen e hulumtimit. Kushti ynë për përpunimin e të dhënave personale të kategorisë së veçantë është që kjo të jetë e nevojshme për qëllime kërkimore shkencore dhe të jetë në interes të publikut.
- Baza ligjore e Universitetit të Oksfordit dhe Institutit të Arsimit UCL për përpunimin e të dhënave është 'detyrë e interesit publik'.
- Kur EEF bëhet kontrollues i të dhënave në fund të projektit ndërkohë që të dhënat e rezultatit të studimit tek fëmijët dorëzohen në arkivin e të dhënave, baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale është pjesë e ' interesave legjitime' . Këto interesa legjitime përfshijnë mbledhjen e të dhënave për të parë se cilat mjedise arsimore apo edukative funksionojnë më mirë, në çfarë kushtesh dhe për cilët nxënës, me synimin për të rritur arritjet dhe për të zvogëluar disavantazhin arsimor.

Kush tjetër ka akses në të dhënat tuaja?

Ekipi i Kërkimit mund t'ua zbulojë informacionin tuaj palëve të treta që kanë lidhje me qëllimet e përpunimit të të dhënave tuaja personale të përcaktuara në këtë njoftim. Këto palë të treta mund të përfshijnë furnitorë, asistentë kërkimorë, partnerë të besuar akademikë dhe nënkontraktorë, të cilët mund të përpunojnë informacione në emër të Ekipit Kërkimor për të kryer punë të tilla si administrimi i testeve, kryerja e intervistave, transkriptimi i intervistave dhe arkivimi i të dhënave. Ata do të përfshijnë gjithashtu mentorët e Talking Time, të cilët do të përpunojnë të dhëna për qëllime të specifikuar, duke përfshirë ofrimin e programit dhe mentorimin. Në të gjitha rastet, Ekipi i Kërkimit do të sigurojë që këto palë të treta të hyjnë në marrëveshje të përshtatshme për përpunimin e të dhënave me ne dhe që ato t'i mbajnë të dhënat tuaja personale të sigurta dhe konfidenciale. Kur të dhënat tuaja ndahen me palët e treta, ne do të kërkojmë që të ndajmë sa më pak të dhëna dhe vetëm ato që janë të nevojshme.

Ne gjithashtu mund të zbulojmë të dhënat tuaj personale nëse kërkohet nga ligji, ose për të mbrojtur veten ose të tjerët kundër aktiviteteve të paligjshme ose të dëmshme, ose si pjesë e një riorganizimi ose ristrukturimi të organizatave tona.

Transfertat ndërkombëtare

Informacioni juaj personal nuk do të transferohet jashtë EEA.

Siguria

Ne marrim të gjitha hapat e arsyeshëm për të mbrojtur informacionin tuaj personal dhe ndjekim procedurat e krijuara për të minimizuar aksesin, ndryshimin, humbjen ose zbulimin e paautorizuar të informacionit tuaj.

Ne kemi krijuar dhe vendosur procedura për t'u marrë me çdo shkelje të dyshuar të të dhënave personale dhe do t'ju njoftojmë ju dhe çdo rregullator të zbatueshëm për ndonjë shkelje ku kërkohet ligjërisht ta bëjmë këtë.

Ruajtja e të dhënave

Ne sigurojmë që të dhënat tuaja të ruhen në mënyrë të sigurt, duke përdorur serverë të sigurt të vendosur brenda MB. Kopjet origjinale elektronike të regjistrimeve video dhe audio të aktiviteteve të grupit do të anonimizohen dhe do të ruhen në mënyrë të sigurt në serverin e dosjeve elektronike të Universitetit të Oksfordit për 3 vjet pas publikimit të raportit të hulumtimit. Vetëm anëtarët e ekipit të Talking Time© (në Oxford, UCL) do të kenë akses tek folderat elektronik. Regjistrimet video dhe audio do të shtypen/do të shkruhen, por nuk do të shkruhen ose raportohen emra të fëmijëve, personelit apo shkollave/çerdheve. Kopjet në letër të formularëve të miratimit do të mbahen gjithmonë në një kabinet dosjesh që është i mbyllur dhe që ndodhet në Departamentin e Arsimit në Universitetin e Oksfordit.

Regjistrimet audio që janë mbledhur nga Qa Research për të ndihmuar në hulumtim do të mblidhen në pajisje të sigurt dhe do të ruhen në mënyrë të sigurt në zyrën e Qa me bazë në MB (Mbretërinë e Bashkuar). Kopjet origjinale elektronike të regjistrimeve audio do të anonimizohen dhe do të ruhen në mënyrë të sigurt në Serverin e Qa për gjashtë muaj pas publikimit të raportit të vlerësimit. Vetëm anëtarët e ekipit të Qa Research do të kenë qasje në këto dosje. Ato mund të ndahen me kolegët e NIESR për qëllime trajnimi

Ne do t'i ruajmë të dhënat tuaja personale vetëm për atë kohë sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimet për të cilat i kemi mbledhur ato, përfshirë qëllimet për përmbushjet e çdo kërkesë ligjore, kontabiliteti ose raportimi. Kur nuk është më e nevojshme të ruajmë për të dhënat tuaja personale, ato do të fshihen në mënyrë të sigurt.

Për të përcaktuar periudhën e duhur të ruajtjes t për të dhënave personale, ne konsiderojmë sasinë, natyrën dhe ndjeshmërinë e të dhënave personale, rrezikun e mundshëm të dëmtimit nga përdorimi i paautorizuar ose zbulimi i të dhënave tuaja personale, qëllimet për të cilat ne përpunojmë të dhënat tuaja personale dhe nëse ne mund t'i arrijmë këto qëllime nëpërmjet mjeteve të tjera dhe kërkesave ligjore të zbatueshme.

- ≠ NIESR do të fshijë të gjitha të dhënat personale tre vjet pas përfundimit të projektit
- ≠ Universiteti i Oksfordit do të fshijë detajet e kontaktit të stafit pas dorëzimit të programit, përveç nëse anëtarët e stafit japin miratimin e tyre që të dhënat e tyre të mbahen në regjistër me qëllim për të marrë raportin e hulumtimit, detaje nga eventet e Talking Time dhe përditësimeve të këtij programi

- ≠ Universiteti i Oksfordit do të mbajë të gjitha të dhënat e tjera personale (p.sh. regjistrimet video ose audio) për tre vjet pas publikimit të raportit përfundimtar të hulumtimit. Pas kësaj, këto të dhëna do të fshihen në mënyrë të sigurt. Të dhënat e anonimizuara (p.sh. transkriptet anonime të regjistrimeve audio/video) mund të mbahen për më gjatë për të mbështetur kërkimet e ardhshme që janë në përputhje me qëllimin origjinal.
- ≠ NIESR do t'i dërgojë të dhënat e rezultateve të hulumtimit që u bënë tek fëmijët në arkivin e Fischer Family Trust (FFT) brenda tre muajve nga përfundimi i projektit. FFT do t'i mbajë të dhënat në emër të EEF, nga ku EEF merr përgjegjësinë për Pajtueshmërinë me Mbrojtjen e të Dhënave

Ju lutemi vini re se, sipas legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave, dhe në përputhje me kushtet përkatëse të përpunimit të të dhënave, të dhënat personale mund të mbahen për periudha më të gjata kohore kur përpunohen thjesht për qëllime arkivimi për interes publik, kërkime shkencore ose historike dhe qëllime statistikore.

Të drejtat tuaja ligjore

Në rrethana të caktuara, ju keni të drejta sipas ligjeve për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me të dhënat tuaja personale dhe dhënave të fëmijës suaj, duke përfshirë të drejtat:

- Për të kërkuar qasje në të dhënat tuaja personale ose për të kërkuar qasje në të dhënat e fëmijës suaj: kjo ju mundëson të merrni një kopje të të dhënave personale që mbajmë për ju dhe të kontrolloni se ne po i përpunojmë ato në mënyrë të ligjshme
- Për të kërkuar korrigjimin e të dhënave personale tuaja ose të fëmijës suaj: kjo ju mundëson të korrigjoni çdo të dhënë të paplotë ose të pasaktë që mbajmë për ju
- Për të kërkuar fshirjen e të dhënave personale ose të fëmijës suaj: kjo ju mundëson të na kërkonit të fshijmë ose të heqim të dhënat personale kur nuk ka asnjë arsye të mirë që ne të vazhdojmë t'i përpunojmë ato
- Për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave tuaja personale ose të të dhënave të fëmijës suaj: ju mund të kundërshtoni kur ne mbështetemi në një interes legjitim (ose tek një pale të tretë) dhe ka diçka të veçantë në lidhje me situatën tuaj që ju bën të dëshironi të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja pasi mendoni se kjo ndikon në të drejtat dhe liritë tuaja themelore
- Për të kërkuar kufizimin e përpunimit të të dhënave personale tuaja ose të fëmijës suaj: Kjo ju mundëson të na kërkonit të pezullojmë përpunimin e të dhënave tuaja personale
- Për të kërkuar transferimin e të dhënave personale tuaja ose të fëmijës suaj
- Të kundërshtojë marketingun e drejtpërdrejtë (përfshirë profilizimin) dhe përpunimin për qëllime të kërkimit shkencor/historik dhe statistikave
- Të mos i nënshtroheni vendimeve të bazuara në procese të automatizuara kur ka ndikim ligjor tek ju

Nëse keni pyetje ose shqetësime mbi mënyrën se si përpunohen të dhënat tuaja, ose dëshironi të ushtroni ndonjë nga të drejtat në lidhje me këtë projekt, mund të kontaktoni:

- Për vlerësimet gjuhësore (përfshirë regjistrimet audio të vlerësimeve) dhe të gjitha të dhënat individuale të fëmijëve të mbledhura nga NIESR: Edoardo Masset TalkingTime@niesr.ac.uk ose dataprotection@niesr.ac.uk.
- Për regjistrimet audio dhe video të aktiviteteve në grup dhe regjistrimet e frekuentimit për seancat e Talking Time: data.protection@admin.ox.ac.uk ose data-protection@ucl.ac.uk

Ju nuk do të duhet të paguani për të pasur akses në të dhënat tuaja personale (ose për të ushtruar ndonjë nga të drejtat e tjera). Megjithatë, ne mund të kërkojmë të paguani një tarifë të arsyeshme nëse kërkesa juaj është qartësisht e pabazuar, e përsëritur ose e tepruar. Përndryshe, ne mund të refuzojmë të përmbushim kërkesën tuaj në këto rrethana.

Nëse kërkon akses në të dhënat tuaja, mund të na duhet të kërkojmë informacion specifik nga ju për të na ndihmuar të konfirmojmë identitetin tuaj dhe të sigurojmë të drejtën tuaj për të pasur akses në të dhënat tuaja personale (ose për të ushtruar ndonjë nga të drejtat tuaja të tjera). Kjo është një masë sigurie për të siguruar që të dhënat personale të mos i zbulohen asnjë personi që nuk ka të drejtë t'i marrë ato. Ne gjithashtu mund t'ju kontaktojmë për t'ju kërkuar informacione të mëtejshme në lidhje me kërkesën tuaj për të përshpejtuar përgjigjen tonë apo procesin.

Ne përpiqemi t'u përgjigjemi të gjitha kërkesave legjitime brenda një muaji. Herë pas here mund të na duhet më shumë se një muaj nëse kërkesa juaj është veçanërisht e ndërlikuar ose nëse keni bërë një numër kërkesash. Në këtë rast, ne do t'ju njoftojmë dhe do t'ju mbajmë të përditësuar.

Nëse keni shqetësime për ndonjë aspekt tjetër të këtij aktiviteti të projektit, ju lutemi kontaktoni:

- Kontakti i etikës NIESR: Katharine Stockland k.stockland@niesr.ac.uk
- Universiteti i Oksfordit: Dr Sandra Mathers talkingtime@education.ox.ac.uk

Ne do të bëjmë çmos për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja. Ne do të pranojmë shqetësimet apo pyetjet tuaja brenda 10 ditëve pune dhe do t'ju tregojmë se si do të trajtohet kërkesa apo shqetësimi juaj. Nëse mbeten të pakënaqur ose dëshironi të bëni një ankesë zyrtare, ju lutemi kontaktoni:

- Ekipi i qeverisjes, etikës dhe sigurimit të Universitetit të Oksfordit (RGEA) në rgea.complaints@admin.ox.ac.uk ose në 01865 616480
- Komiteti i Etikës NIESR: Katharine Stockland k.stockland@niesr.ac.uk

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë deklaratë privatësie, duke përfshirë çdo kërkesë për të ushtruar të drejtat tuaja ligjore në lidhje me të dhënat tuaja personale, ju lutemi kontaktoni në radhë të parë NIESR.

NIESR, 2 Dean Trench Street, Londër, SW1P 3HE

Email: TalkingTime@niesr.ac.uk

Ju gjithashtu keni të drejtë të bëni një ankesë në çdo kohë pranë Zyrës së Komisionerit të Informacionit (ICO), autoritetit mbikëqyrës të MB për çështjet e mbrojtjes së të dhënave (www.ico.org.uk). Megjithatë, ne mund të jemi në gjendje të adresojmë shqetësimet tuaja, kështu që ju lutemi kontaktoni fillimisht NIESR.

Ndryshimet në këtë deklaratë

Ne mund ta ndryshojmë këtë Deklaratë të Privatësisë herë pas here. Nëse bëjmë ndonjë ndryshim të rëndësishëm në mënyrën se si i trajtojmë të dhënat tuaja personale, do t'i bëjmë të qarta këto ndryshime duke kontaktuar çerdhen e fëmijës suaj dhe duke u siguruar që ata t'ju ofrojnë një version të përditësuar të kësaj Deklarate të privatësisë.

Detajet e kompanisë për ekipin kërkimor dhe financuesin

- NIESR është një kompani e listuar me regjistrimin e garancisë në Angli dhe po ashtu është një organizatë e regjistruar bamirësie.
 - Numri i kompanisë: 341010
 - Numri i regjistrimit të bamirësisë: 306083
 - Zyra e regjistruar: NESR, 2 Dean Trench Street, Smith Square, Londër SW1P 3HE
 - Email: TalkingTime@niesr.ac.uk
- Universiteti i Oksfordit është një korporatë civile. Universiteti gëzon statusin e bamirësisë si një nga bamirësitë speciale të listuara në Shtojcën 3 të Aktit të Bamirësisë 2011
 - Zyra e regjistruar: Zyrat e Universitetit, Sheshi Wellington, Oxford, OX1 2JD
 - Email: data.protection@admin.ox.ac.uk
- Fondacioni Edukativ Endowment është një organizatë bamirëse e regjistruar në Angli
 - Zyra e regjistruar: Millbank Tower, 21-24 Millbank, Londër SW1P 4QP
 - Numri i regjistrimit të bamirësisë: 1142111
 - Numri i kompanisë: 07587909
 - Email: info@eefoundation.org.uk